

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 9-2018

ROLI I NATO-S NË SIGURINË E BALLKANIT PERËNDIMOR

Drenushë Osmani

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

Recommended Citation

Osmani, Drenushë, "ROLI I NATO-S NË SIGURINË E BALLKANIT PERËNDIMOR" (2018). *Theses and Dissertations*. 278.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/278>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

ROLI I NATO-S NË SIGURINË E BALLKANIT PERËNDIMOR

Shkalla Bachelor

Drenushë Osmani

Shtator, 2018

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2014-2015

Drenushë Osmani

ROLI I NATO-S NË SIGURINË E BALLKANIT PERËNDIMOR

Mentori: Dr.sc. Alfred Marleku

Shtator, 2018

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Qëllim i kësaj teme të diplomës është të analizoj rolin që ka NATO, si organizatë regjionale dhe si një ndër organizatat ndërqeveritare më tërëndësishme në fushën e sigurisë sot në botë. Punimi do të zhvillohet në dy rrafshe. Nënjerën anë do të shtjellohet ideja dhe zhvillimi i NATO-s, që nga themelimi i saj deri në ditët e sotme. Roli, rëndësia dhe pesha politike e saj si gjatë Luftës së Ftohtë, pas saj e deri në ditët e sotme. Në rrafshin tjetër do të trajtohet aspekti më praktik i efektit të kësaj organizatë në rajonin e Ballkanit. Metoda e përdorur për të gjetur dhe analizuar këto të dhëna është mbështetur në qasjen cilësore duke përdorur edhe të dhëna nga burimet sekondare me qëllim të begatimit të temës me gjetjet dhe statistikën e fundit në fushë. Punimi konkludon se roli dhe rëndësia e NATO-s si aktorë i marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe i shteteve anëtare me influencë në këtë organizatë, është dhe mbetet jetik për ruajtjen e paqes dhe sigurisë për Ballkan.

Fjalët kyçe:*NATO, siguri, Ballkan kërcenim, konflikt.*

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Pjesa e studimit e kësaj teme diploma-Bachelor, është punuar me literaturën kryesisht që e kemi përdorur gjatë këtyre tre viteve studimi dhe librat e tjera shtesë. Kjo temë diplome është punuar brenda objektit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Prishtinë. Kam kënaqësinë të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen time më të thellë për personat të cilët më kanë dhënë mbështetjen e tyre gjatë gjithë kësaj kohe që kam punuar në këtë punim.

Mentorit tim Prof. Dr. Alfred Marlekut, i takon falënderim më i veçantë për strukturën, koordinimin, ndihmën, mirësinë, sinqeritetin dhe udhëheqjen profesionale që ja kam besuar për finalizimin e këtij punimi, si dhe mbështetjen konkrete në fazën e studimit dhe hulumtimit të punimit. Asnjëherë nuk do të arrij ta shpreh falënderimin tim ashtu siç nga thellësia e zemrës e ndjej ndaj familjes sime e veçanërisht për babin tim, për durimin, mirëkuptimin dhe përkrahjen në të gjitha fazat e ngritjes sime akademike. Kjo rrugë nuk do të ishte e lehtë dhe e mundur pa mbështetjen e tyre.

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	V
2	SHQYRTIMI I LITERATURES	1
2.1	Vështrimi historik dhe teorik mbi NATO-n.....	1
2.1.1	Fillesat e NATO-s.....	1
2.1.2	Qëllimet dhe parimet e NATO-s	2
2.2	Shtetet e rajonit të Ballkanit vis-a-vis NATO-s	5
2.2.1	.Lufta në Kosovë dhe përfshirja e NATO-s.....	5
2.2.2	Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe gjendja sot	9
2.3	Rasti i Bosnje dhe Hercegovinës	11
2.3.1	NATO dhe roli i saj në luftën e B&H.....	12
2.4	. Rasti i Malit të Zi	13
2.4.1	Mali i Zi dhe anëtarësimi në NATO	14
2.5	Rasti i Maqedonisë.....	14
2.6	Maqedonia dhe NATO-ja	15
2.7	Rasti i Serbisë	16
2.7.1	Rezultatet emisioneve të NATO-s në Ballkan.....	17
2.7.2	Kërkesat e NATO-s, ndaj Ballkanit perëndimor për anëtarësim.....	18
3	DEKLARIMI I PROBLEMIT	21
4	METODOLOGJIA.....	22
5	KONKLuzionet dhe Rekomandimet	23
7	REFERENCAT	25

FJALORI I TERMAVE

BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për Sundimit të Ligjit në Kosovë
FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
IFOR	Implementation Force
KS	Këshilli i Sigurimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PpP	Partneriteti për Paqe
SFOR	Forca e Stabilizimit në Bosnjë dhe Hercegovinë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNPROFOR	Forca e Mbrojtjes e Kombeve të Bashkuara

1 HYRJE

Duke e parë se në çfarë etapash kemi kaluar e çfarë nuk kemi heçur për të ardhur deri këtu ku jemi, patjetër që duhet kujtuar gjithmonë se kush na doli në krahë e ndihmë atëherë kur ne kishim nevojë më së shumti dhe se shpresat madje edhe ishin shuar. Për të shtjelluar këtë temë dhe për tu studiuar nga afër kryesisht kam përdorur literaturën që e kemi përdorur gjatë këtyre tre viteve studime dhe poashtu dokumentet e ndryshme online.. Në kapitullin e parë më shumë jam fokusuar në krijimin e NATO-s në përgjithësi objektivin e krijimit të sajë etj. Në kapitullin e dytë kam përzgjedhur që të flas për parimet dhe qëllimet e NATO-s, kurse në kapitujt e tjerë si objekt studimi jam përcaktuar në shtetet e Ballkanit perëndimor dhe misionet e NATO-s ndër vite.

Ky punim diplomeështë i përbërë nga katër pjesë kryesore. Në pjesën e parë trajtohet qëllimi i NATO-s, objektivat e NATO-s si u formua dhe pse lindi ajo. Kurse në pjesën e dytë theksi bie mbi faktin se si filloi lufta në Kosovë, dhe si e trajtuan organizatat botërore rastin e Kosovës, si dhe pse pati një hap ma shumë nga ana e NATO-s. Në pjesën e tretë kam analizuar se cila ishte arsyeja që filloi lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë, kurse në kapitullin e katërt kam folur nëpërgjithësi për shtetet e Ballkanit perëndimorë dhe ndikimit të NATO-s në këtë pjesë.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Vështrimi historik dhe teorik mbi NATO-n

2.1.1 Fillesat e NATO-s

NATO si organizatë ushtarake u formua me 4 prill në vitin 1949. Pas Luftës së Dytë Botërore, në një atmosferë jo shumëpaqësore që shpesh herëkonsiderohej si një atmosferë ankthi për shtetet perëndimore e cila shkaktohej për shkak të zgjerimit të bashkimit sovjetik në Evropë, me formimin e NATO-s ky ankth u zvogëlua dukshëm. Kjo ndodhi sepse shtetet perëndimore arritën të krijonin një kundërpeshë ushtarake dhe strategjike kundrejt Bashkimit Sovjetik. Atë botë, pas Luftës së Dytë Botërore, kur Evropa ishte e ndarë ndërmjet lindjes, e cila përbëhej nga (shtetet Komuniste të Evropës qendrore dhe lindore tëudhëhequra nga Bashkimi Sovjetik), dhe në anën tjetër perëndimit, që udhëhiqej nga shtetet demokratike të Evropës Perëndimore, NATO-ja është aleanca ushtarake më e fortë në botë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë falë misioneve të zhvilluara në shumë pjesë të botës në të cilat është kërcënuar paqja dhe stabiliteti. Me ndërhyrjen dhe ndihmën e ofruar nga NATO këto shtete janë ndihmuar që të ndalin konfliktin dhe, në të shumtën e rasteve, të fillojnë një proces të paqekrijimit dhe konsolidimit të institucioneve shtetërore në fusha të ndryshme si: institucione dhe procedura demokratike, sundim i ligjit, zhvillim ekonomik, konsolidim i vlerave demokratike etj.

NATO tradicionalisht ka theksuar se objektivi apo qëllimi i saj kryesor është “civilizimi ianëtarëve duke promovuar stabilitet dhe mirëqenie në zonën e atlantikut të veriut” (Ikubal, 2018). Motoja e NATO-s gjithashtu përfshin parimin se nëse një vend do tëkërcënohej nga ndonjë sulm, atëherë të gjithë shtetet anëtare do t’i dilnin në mbrojtje atij vendi. Me pak fjalë, gjithë ideja bazohej në parimin mesjetar të muskjetërëve që thotë, “një për të gjithë, të gjithë për një”. Në fillim NATO-ja në vete përbënte 12 shtete, por më vonë u zgjerua për të përfshirë në gjirin e saj “Greqinë dhe Turqinë (1952), si dhe Gjermaninë Perëndimore në vitin 1955” (Ikubal, 2018). Padyshim që si në fillim të formimit të saj NATO-ja, ashtu si edhe sot, është dominuar ushtarakisht, dhe në aspektin politik gjithashtu, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kjodo të thotë se përdorimi i të mirave kolektive i përfshin aktivitete dhe përzgjedhje që janë të ndërrarura nga njëra tjetra. Vendimet e një shteti kanë efekte për shtetet tjera, nga kjo vijmë në një përfundim se shtetet mund të vuajnë pasoja negative, të paparashikuara si rezultat i veprimeve të tjerëve.

2.1.2 Qëllimet dhe parimet e NATO-s

Si një organizatë që po merrte vrullin e menjëhershme, dhe si një aktorë dhe subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare, padyshim që kishte disaqëllime dhe parime që duhej respektuar e zbatuar në arenën ndërkombëtare. Njëra nga shumë pikat kryesore është ekuilibri ifuqisë, i shtjelluar më së miri nga teoricienët realist, e cila i mbijetoi gjatë periudhave të tranzicionit. Fundi i Luftës së Ftohtë përfaqëson saktësisht një tranzicion të tillë, ku edhe NATO-ja ishte në fillimet e saj të ekzistimit, i cili ky tranzicion ndikoi thellësisht në rolin e NATO-s .

Aleancë kjo që peshonte rëndë në arenën ushtarake e ndërkombëtare e Perëndimore, e krijuar pas luftës së dytë botërore, e cila si objekt kryesor kishte për “t’iu kundërvë kërcënimit që i kanosej nga bashkimi sovjetik”(Mingst, 2010, f.289) NATO qysh në formimin e sajë si një aleancë kryesore perëndimore pati dy zgjerime,apo faza, nëpër të cilën kaloi e të cilat ishin shumë të rëndësishme në historinë e sajë. E para ajo e vitit 1997 ku Polonia, Hungaria dhe Republika Çeke u pranuan me të drejta të plota në NATO.

Zgjerimi i dytë u realizua në vitin “2003, ku iu bashkëngjiten dymbëdhjetë shtete siç janë: Estonia, Lituania, Letonia, Sllovakia, Sllovenia Rumania dhe Bullgaria”(Mingst, 2010, f.289) Me këtë u arrit edhe numri po thuajse i duhur e pjesëmarrjeve, nga shtetet e botës e cila u arrit deri në 27 vende anëtare. Nga krejt kjo rrjedh një gjë shumë e rëndësishme sepse NATO-ja krijoi në një farë mënyre partneritetin për paqe ku bëjnë pjesë 27 vende anëtare dhe 7 shtete të dialogut mesdhetar.

Padyshim që ajo ka pasur edhe kundërshtime. Në këtë drejtim kundërshtimi më i madh i saj ka qenë Rusia që në mënyrë të vazhdueshme do ta thumbonte dhe kundërshtonte zgjerimin e saj sepse për të shtrirja e NATO-s ishte një kërcënim ushtarak.Si mbështetje dhe aktor kryesor i NATO-s, ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zgjerim ku ata e shihnin si diçka

të natyrshme që ishte rezultat i fitimit të Luftës së Ftohtë dhe krijimit të një Rendi të Ri pas përfundimit të saj.

Në marrëdhëniet Ndërkombëtare, gjatë studimeve dhe analizave të shumta, janë ekzaminuar deri në detaje edhe disa teori më kryesoret dhe ato zgjerimin e NATO-s e shohin në prizma të ndryshme. “Realistët e shohin zgjerimin e NATO-s si një mjet për të kapur përfitimet relative ndaj Rusisë. Kurse, nëse shikojmë nga pikëpamjet liberale, ata zgjerimin e NATO-Se shohin si një mjet për të forcuar demokracinë në vendet ish-komuniste”(Mingst, 2010 f.290). Nga ana tjetër, NATO-ja ka punuar në një periudhë afatgjatë me Rusinë për ta bindur këtë të fundit se zgjerimi i organizatës nuk është kërcënim për të dhe se nuk ka qëllime negative ndaj Rusisë. Përkundrazi, ajo pas një sërë mundimesh arriti ta legjitimoj dialogun me Rusinë për çështjet themelore që në një far mënyre kanë të bëjnë me sigurinë e Rusisë.

Padyshim që ka edhe nga ata që e vuan në pikëpyetje jetesën e NATO-s, si organizatë me mbarimin e kërcënimit sovjetik, ku shumë studiues në fillim parashtuan pyetjen nëse NATO do të duhej të ekzistonte. Por këto pyetje morën fund me Luftën tragjike në ish-Jugosllavi, si dhe me krizën e refugjatëve që pasoi në Evropë, dhe kjo ndihmoi që NATO mori gjithnjë e më shumë role paqeruajtëse në vendet që kishin nevojë për krijimin e paqes dhe zbatimin e saj. Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut është një nga institucionet ndërkombëtare më të mëdha të botës. Ajo është një aleancë politike dhe ushtarake e cila mbledh së bashku 29 vende anëtare nga Evropa dhe Amerika e Veriut. Këto vende mblidhen për t’u këshilluar dhe për të bashkëpunuar në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Për këtë, NATO siguron një lidhje unike në mes të këtyre dy kontinenteve për bashkëpunim politik dhe siguri.

Është e themeluar “LIIB për realizimin e një politike gjeostrategjike që kishte për qëllim rindërtimin e Evropës të shkatërruar nga lufta përmes planit të quajtur “Marrshall”, si dhe ruajtjen e integritetit evropian duke mos lejuar ndarjen ideologjike” (Mingst,2010 f.310).NATO, si një organizatë me ndikim shumë të madh në botë ka pasur disa faza të transformimit të saj që nëse analizohet nga aspekti i funksionimit të saj në kohën e themelimit, ajo nuk është parë të ketë kesi lloj funksionesh që kryen sot, andaj duke parë

rrethanat që zhvillohen në politikat ndërkombëtare NATO ka bërë disa faza të transformimit të saj.

- Faza e parë, 1949-1995 – Kjo fazë e parë përfshinë misionin themelor të krijimit të kësaj aleance që ky mision kishte për synim parandalimin e ndikim sovjeti si dhe ndërhyrjes të sovjetike në Evropë përmes instrumenteve gjeostrategjike si dhe gjeopolitike. Këto instrumente të politikës së NATO-s parashihnin ruajtjen e paqes dhe mos lejinin e destabilizimit të Evropës si dhe mos lejinin e ndarjes së Evropës nga kërcënimet e Luftës së Ftohtë.
- Faza e dytë, 1995-2001 – Kjo është faza kryesore e transformimit të NATO-s pasi që pas përfundimit të Luftës së Ftohtë erdhi ideja e transformimit nga një aleancë ushtarake, në një organizatë ushtarake-politike të imponimit të paqes dhe vlerave demokratike perëndimore. Kjo fazë e transformimit përfshinte edhe intervenimin e parë jashtë organizatës (1995 në Bosnje & Hercegovinë dhe 1999 në Kosovë)
- Faza e tretë, 2001-2008 – Në këtë fazë hynë përfshirja e NATO-s në luftën kundër terrorizmit global dhe përfshirjen e trupave të NATO-s në Afganistan dhe Irak.
- Faza e katërt, 2008-2015 – Kjo fazë ndryshe njihet edhe si faza e rikthimit të NATO-s në misionin origjinal të saj pasi që shohim një Rusi e cila është rikthyer në lavdinë e dikurshme të fuqisë së saj pas aneksimit të krahinave në Gjeorgji (2008), aneksimin e Krimes në Ukrainë (2014) si dhe bombardimi në Siri (2015) (Reka et al, 2016).

2.2 Shtetet e rajonit të Ballkanit vis-a-vis NATO-s

2.2.1 Lufta në Kosovë dhe përfshirja e NATO-s

Me fillimin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në shesh dolën konfliktet e shumë gjëra po merrnin drejtim të gabuar dhe jotë menduar. Nga këto problem që dolën nga shpërbërja e kësaj federate përbënë thelbin e shkaqeve të luftës duke prekur çështjen e vetëvendosjes, të drejtat individëve dhe ato të grupit të ushtrimit dhe të kufizimit të sovranitetit si dhe një mungesë të arbitrit në sistemin ndërkombëtar.

Konflikti kryesor Jugosllav përfshiu edhe territorin e Kosovës, që këtë të fundit e quanin si diçka të tyre dhe përbënte në vete historinë e tyre. Konflikti i Jugosllavisë ishte bërthama e fillimit të një epoke të re e cila me përfundimin e luftës përfunduan edhe pazarllëqet dhe sundimet serbe në tokat Shqiptare. Kryesisht Lufta e Jugosllavisë ishte shkaktuar nga veprimet e individëve sepse në mes tyre gjithmonë kishte pasur kundërshtime dhe të gjithë e dinin se fundi do të ishte i tillë, sepse që moti filluan përgatitjet për çlirim. Padyshim që Kosova është një vend mjaft i begatshëm dhe e përmbushur me pasuritë e saja, si mbi sipërfaqen e tokës ashtu edhe nën sipërfaqen. Kosova gjithmonë me vetë ka bartur interesin e popujve të ndryshme për gjatë tërë historisë, duke u lakmuar, me një farë fjale, më së shumti nga populli serbo-sllav e që barti pasoja të mëdha gjatë evoluimit historik.

Kosova e pozicionuar në zemër të Ballkanit Perëndimorë, si një kryqëzim i akseve rrugore automobilistike hekurudhore, si dhe hapësira ajrore si një dhuratë nga vetë natyra dhe si rrafshnaltë e sigurt, padyshim që do të ishte pikësynim i çdo vendi. Rëndësia e Kosovës u vërtetua nga vetë historia gjatë zhvillimeve të shoqërisë njerëzore, që nga përleshja e perandorive të ndryshme e deri në këto kohë moderne, ku serbët gjithmonë përgjakën tokën Shqiptare e të shumëvujtur çdo herë që kërkonin lirinë. Lakmia për të përvetësuar pasurinë e dikujt tjetër ka shtyrë gjithmonë njerëzit në konflikte luftarake, dhe kështu ndodhi edhe në Kosovë. Është shumë e vërtetë që Kosova ka pasuri të bollshme dhe ato gjenden në minierat e sajë që shtrihen nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Nuk duhet harruar asesi rezervat e qymyrgurit dhe të linjtit pasuri këto qenënjefarë forme vërtetuan rëndësinë e Kosovës, dhe sa herë që ky popull u ngrit në këmbë për ta kërkuar atë që ju takoi, u përmbysën nga mizoria serbe.

Lufta e Ballkanit Perëndimor padyshim që nuk filloi me Kosovën, por ajo së pari nisi në Slloveni, për të vazhduar kështu në Kroaci, në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe njëherazi ja doli edhe ta trondiste botën me masakrën e Srebrenicës. Kjo mizori serbe mori jetën e shumë të rinjve. Edhe pse boshnjakët u përmbysën nga Serbët, ajo u ndje e rrezikuar edhe nga kroatët të cilët u vërsulën që ta merrnin atë që nuk u takonte. Edhe pse populli serb kishte prekur edhe në Slloveni, e gjendur në kufi me perëndimin, ajo u shkëput nga Beogradi me vuajtje që i riparoi shpejtë. Pa u lagur fare dhe pa u prekur aspak nga kjo frymë që e kishte kapluar Ballkanin, doli nga kjo krahurë ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Pas konferencës së Dejtonit në ShBA, Serbia duke e parë vetën jo në atë se çka kishte menduar aktivizoi forcat e saja në sulm të paparë kundër Kosovës. Në anën tjetër, bota e ndodhur kundrejt këtij realiteti tëhidhur ndjeu një përgjegjësi morale ndaj “varrit masiv” që kishte nisur të hapej në Kosovë. Diplomacia dhe Politika, të dyja këto më tepër se kurrë, u bashkuan dhe e vendosën të ndërmerrnin hapa të ri për të parandaluar tragjedinë e re pas asaj që kishte ndodhur në Srebrenicë. Pasi dështuan një herë nga “keq menaxhimi, mirëmendimi, planifikimi dhe parashikimi, morën hap të rëndësishëm që t’i ndihmonin Kosovës me forcat ajrore të tyre” (Emini, 2016, f.1-20). Shqiptarët e Kosovës asnjëherë nuk e humbën durimin, por vazhduan me kokën lartë, dhe lëvizën brenda vetës duke u organizuar ushtarakisht në mënyrën e duhur për t’u përgjigjur ripushtimit ushtarak e kolonial të Beogradit.

Në vitin “1974 Kosova merr statusin e Krahinës Autonome brenda Republikës Serbe të Jugosllavisë”(Emini, 2016, f.1-20). Por, pas tërë këtyre përpjekjeve punët u ngatërruan edhe mëkeq me zgjedhjen e presidentit Serb Slobodan Miloseviq, ku ky i hoqi autonominë Kosovës duke e dërguar Kosovën në trazira dhe kërcënime ndaj kontrollit qeveritar. Pas shumë konflikteve, dhunimeve e masakrimeve rinia e Kosovës organizoi demonstrata e protesta, që në të shumtën e rasteve përfunduan me vrasje e burgosje. Me një fjalë, nuk kishte mbetur më zgjidhje tjetër dhe pas tërë këtyre trazirave në vitin “1997 u formuan trupa guerile nga djemtë dhe vajzat e Kosovës të cilat nisën të ndërmarrin aksione të vogla e që më pas u shndërruan në Ushtri Çlirimtare të Kosovës”(Emini, 2016, f.1-20).

Nuk shkoi gjatë dhe situata u përshkallëzua edhe më shumë kur serbët vendosën të kundërvepronin me forca masive kundër shqiptarëve të Kosovës. Edhe pse Organizata e

Kombeve të Bashkuara (OKB) urdhëruan ndaljen e vrasjeve ku si pasojë u nxorën shumë rezoluta, forcat serbe nuk ju bindën asnjërës prej tyre. Kështu, në mars të vitit 1999, të tmerruar ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut e posaçërisht pas masakrës së Reçakut, forcat e NATO-s ndërhyjnë kundër qaceve serbe në Kosovë dhe Serbi gjithashtu. Duhet theksuar se kjo ndërhyrje ndodhi pas zhvillimeve që ndodhen në “(Rambuqe në bisedimet për zgjidhjen e krizës së Kosovës në mes të delegacionit nga Kosova (të përbërë si nga krahu i paqes, ashtu edhe ai i luftës) dhe atij të Serbisë– kuptohet nën ndërmjetësimin rigoroz të bashkësisë ndërkombëtare. NATO filloi që t’i bombardojnë objektivat ushtarake dhe strategjike serbe” (Emini, 2016, f.1-20). Ky bombardim në total u zhvillua në luftë ajrore 78 ditë kundër republikës Federale të Jugosllavisë. NATO dhe autoritetet ushtarake jugosllave nënshkruan marrëveshjen për heqjen e forcave jugosllave të sigurisë nga Kosova. Por, kjo ndërhyrje edhe pse u diskutua si e ligjshme apo jo në arenën e debatit politik, nuk rezultoi e dëmshme në planin afatgjatë as për NATO-n dhe Kombet e Bashkuara. Përkundrazi, sulmet e NATO-s ishin veprime me peshë shumë të mëdha ushtarake, dhe se ajo për “herë të parë përdori forcën e sajë ndaj një shteti sovran pa aprovimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, por nga ana tjetër ishte e ligjshme se u bazuan në të drejtën humanitare sepse kjo luftë po merrte jetën e shumë njerëzve civil” (Avdiu, 2017).

NATO ishte ajo që mundësoj parandalimin e spastrimit etnik nga ana e serbëve në Kosovë. “Përmbytja e udhëheqjes serbe bëri që Slobodan Millosheviqi të dërgohej në Gjykatën e Krimeve të Luftës në ish Jugosllavi në Hagë të Holandës” (Mingst. 2010). Pas shumë vitesh mudi e sakrifice që të kemi një bashkëpunim me NATO-n, dëshira e Kosovës pothuajse u realizua, me vendosjen e kornizës për bashkëpunim duke i ofruar mundësinë Kosovës të përfshihet në programet e caktuara të NATO-s për institucione shtetërore dhe jo shtetërore. Që nga viti 2017 Kosova filloi të marrë pjesë në programet dhe instrumentet e NATO-s, i cili i mundësoi asaj komunikim më të shpeshtë dhe vizitatë rregullta të zyrtarëve të lartë të NATO-s. Si përshembull, të marrë pjesë në programin për ndërtimin e “Integritetit, programin e Diplomacisë Publike, dhe pjesëmarrja e mundshme e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës si vëzhguese në ushtrimet e qendrës koordinuese Euro-Atlantike në rast se ka ndonjë fatkeqësi” (Avdiu, 2017).

Nga kjo lë të kuptohet se edhe pas të gjithave këtyre mundësive që NATO-ja ja ofroi, Kosova ende nuk e ka statusin e partnerit të NATO-s, kjo për një arsye shumë të përfolur sepse katër nga vendet anëtare nuk e kanë njohur Kosovën, dhe ato janë Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. Edhe pse është hedhur një hap lidhur me bashkëpunimin mes NATO-s dhe Kosovës, ajo është shumë e vogël me atë se çka në të vërtetë meriton shteti i Kosovës. Kosova nga njëra anë i plotëson kushtet profesionale dhe politike, por pasi siç ucek edhe më lartë, nëse nuk aprovohet nga të gjitha shtetet anëtare të NATO-s ajo kurrë nuk do të jetë pjesë e sajë.

Për të përshpejtuar këtë proces, në nëntor të vitit 2015 kryeministri i asaj kohe i Kosovës, Isa Mustafa, i dërgoi një letër sekretari të përgjithshëm të NATO-s, për vendosjen e marrëdhënieve politike ndërmjet NATO-s dhe Kosovës. Një përgjigje e tillë u kthye një vit më vonë. Përgjigja ishte përgatitur me kujdes të veçantë dhe që trajtonte temën e institucioneve të Kosovës në lidhje me bashkëpunimin se NATO-ja do të gjente një formë bashkëpunimi i cili në plan kishte të fillonte në vitin 2017, por duke e pasur gjithmonë parasysh që një partneritet i vendosur ende nuk kishte plotësuar kushtet që të pranohej nga katër vendet anëtare (Avdiu, 2017).

NATO-ja përbehet nga 29 vende anëtare, nga Evropa dhe Amerika Veriore. Kjo organizatë ka zhvilluar në vazhdimësi forma të bashkëpunimit me vendet partnere ose vendet që nuk kanë qenë partnere të NATO-s, përmes programeve të ndryshme të partneritetit. Pra, aktivitetet e NATO-s janë krijuar dhe zhvilluar me qëllim të fuqizimit të dialogut politik dhe bashkëpunimit praktik mes vendeve partneredhe NATO-s për të kontribuar në paqen dhe sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare.

2.2.2 Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe gjendja sot

Pas luftës që u zhvillua në Kosovë ajo arriti që pavarësinë e saj më shumë mund ta shpallë më 17 shkurt 2008, duke u mbështetur në vlerat e parimet demokratike me përkrahjen e fuqishme të politikës amerikane. Ajo u vendos nën bazën më të madhe ushtarake të Shteteve të Bashkuara të cilën e morën njëterritor të dëshirueshëm në Kosovë e cila ende funksionon në territorin e Kosovës. NATO ende nuk ka filluar raporte institucionale me Kosovën në mënyrë që t'i siguroj asaj anëtarësim. Kuptohet që Kosova fillimisht duhet të plotësoj disa kriteret të rëndësishme të cilat përfshijnë shumë pika si “partneritet për paqe, planin e veprimit për anëtarësim, lufta serioze dhe me rezultate konkrete kundër korrupsionit e krimit të organizuar dheshumë e shumë kriteret tjera”¹ (Avdiu, 2017).

Njëqind e dhjetë nga 193 vende anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por jo edhe pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian (Qiproja, Greqia, Rumania, Spanja dhe Sllovakia). Prandaj, pozicioni origjinal i BE ka qenë të mos nënshkruajë një zhvillim institucionale me Kosovën derisa të gjithë anëtarët nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Kosova ende është objekt i politikës ndërkombëtare sepse ata ende janë të pranishëm në territorin e saj nga ana e forcave ndërkombëtare siç është NATO-ja dhe Unionit Evropian (KFOR dhe EULEX) (Avdiu, 2017).

Kosovën shpesh herë ditën edhe ta shfrytëzonin në mënyra të ndryshme, shembull donator i sajë më i madh BE e shfrytëzoi situatën e krizës në zonën kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe si rrjedhojë patëm Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe mbështetjen me 2 maj 2014. Edhe pse bënë përpjekje të njëpasnjëshme NATO ende nuk ka vendosur zhvillim institucional me Kosovën me qëllim që t'i ofrojë asaj anëtarësimin në programet e tyre që i paraprijnë anëtarësimit të plotë.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta në sektorin e ekonomisë, Kosova është ende larg nga rritja ekonomike, stabiliteti politik. Shteti i cili ka popullsinë më të re në Evropë, e cila posedon një rritje arsimore nga ana e të rinjve, të cilët ende kanë vështirësi që të dalin jashtë vendit të

tyre, dhe kërkimi i tyre i vazhdueshëm për daljen e tyre jashtë shtetit është i rezultat e pamundësisë së punësuarit në vendin e tyre. Që nga përfundimi i luftës Kosova, u përball me një shkallë të lartë emigracioni nga të gjitha grupet sociale të popullsisë së sajë, duke përfshirë këtu edhe ngritjen e lartë të aktiviteteve kriminale, rritja e korrupsionit etj.

Humbja e shpresës ekonomike rezultoi me bashkimin e popullsisë Kosovare me atë të luftëtareve në ISS-it në Siri dhe Irak. Ajo çka i shuajti shpresat është edhe regjimi i vizave i cili ka dëmtuar rëndë ekonominë dhe politikën e Kosovës e cila pamundëson lëvizjen e lirë të njerëzve apo edhe qarkullimin e mallrave pa dogana në mbarë Evropën bëri që emigracioni të rritej dukshëm dhe që t'iu bashkëngjiteshin punëve ilegale e terroriste. Ndonëse NATO-ja është e përfshirë në Kosovë prej 15 vitesh dhe përkundër faktit që të gjitha vendet fqinje të Kosovës i janë bashkuar programit Partneriteti për Paqe (PpP) të NATO-s, “Kosova është vendi i vetëm që ka mbetur jashtë procesit të zgjerimit të NATO-s Kosova nuk ka vendosur ndonjë marrëdhënie zyrtare, dypalëshe apo kontraktuale me NATO-n dhe, për më shumë, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk ka asnjë bashkëpunim me KVA-në e NATO-s” (Mingst, 2010, f. 289). Gjithashtu, sa i përket bashkëpunimit me NATO-n, Kosova, përkatësisht institucionet dhe mekanizmat e saj janë të bllokuara në të gjitha aspektet duke mos e gëzuar të drejtën e pjesëmarrjes në mekanizmat bashkëpunues dhe programet e ndryshme të NATO-s, si pasojë e qëndrimit neutral të kësaj të fundit ndaj Kosovës.

Megjithatë, Kosova ka arritur të pranohet dhe të përfaqësohet në njërin nga trupat politike të NATO-s, sepse nga viti “2014 Kuvendi i Kosovës edhe zyrtarisht është pranuar si vëzhgues në Asamblenë Parlamentare të NATO-s” (Avdiu, 2017). Deputetët e Kuvendit të Kosovës, respektivisht dy nga ta, mund të marrin pjesë në kapacitetin e vëzhguesit në mbledhjet e asamblesë parlamentare të NATO-s. Kjo nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohet si ndonjë hap real lidhur me anëtarësimin e mundshëm të Kosovës në NATO,” pasi që AP është institucion i ndarë nga struktura dhe organogrami zyrtar i NATO-s dhe, si e tillë funksionon pavarësisht nga NATO-ja” (Avdiu, 2017).

2.3 Rasti i Bosnje dhe Hercegovinës

Ende pa filluar lufta në këtë vend, Këshilli i Sigurimit (KS) krijoi një strehë sigurie në Bosnjë dhe Hercegovinë, por njëra nga gabimet që dërgoi në dështimin e sajë ka qenë se ajo nuk “kontrolloi nëse palët ishin dakord mes vete, dhe se nuk ndryshuan mandatin e UNPROFOR dhe poashtu nuk u ofroi trupave ushtarake shtesë për sigurinë në zonat e kërcënuara”(Amstrong, 2012, *f. 139*).

Në fakt Masakra e Sebrenicës solli përshpejtimin e ndërhyrjes të trupave ushtarake të NATO-s dhe aktivizimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Pasi filloi luftimi serbët kundër boshnjakeve në këmbë ishin ngritur edhe bota ndërkombëtare e cila shtoi në maksimum përpjekjet, kërcënimet, presionet për të arritur fundin e konfliktit dhe fillimin e ri të paqes. “Lidershipine faktorit ndërkombëtar për zgjidhjen e kontekstit të krizës së Ballkanit perëndimor e përbënin amerikanët, të cilët edhe e kryesonin sulmin e NATO-s”(Kumanova, 2018)

Për një zgjidhje ishin duke menduar të gjithë se si ta ndalojnë këtë rrezik i cili kishte mbretëruar nëpër rrugët e Bosnjës, dhe ajo qëja arriti ta ndalonte në njëfarë mënyre ka qenë Marrëveshja e Dejtonit e cila për qëllim kishte ndaljen e konfliktit të armatosur mes palëve dhe që ta sillte paqen në Bosnje dhe Hercegovinë, edhe pse brenda kësaj marrëveshje pati diskriminime të cilat janë vërtetuar nga shumëekspertë e shpesh thanë që nuk duhej të nënshkruhej,por për hirë të asaj qëçdo gjë e kishte humbur kuptimin e vet duhej të ndodhte patjetër çoftë apo jo me rezultate fitim prurëse.

2.3.1 NATO dhe roli i saj në luftën e B&H

Me kontributin e NATO-s në këtë krizë nuk rezultoi as shumë mirë as shumë keq, sepse bëri që serbët të kërkonin fundin e luftës, kurse nga ana tjetër pësuan humbje të papara shikueshme e cila përfundoi me nënshkrimin e marrëveshjes së Dejtonit, që i dhanë fund konfliktit. Pas kësaj Forcat e Kombeve të bashkuara u zëvendësuan nga forcat e implementimit të udhëhequr nga “IFOR e cila kishte pushtetin dhe aftësinë të implementonte masat mbrojtëse dhe imponuese të autorizuara nga Kombet e Bashkuara”(Mingst, 2010, f. 289).

“Përgjegjësia e IFOR ishte imponimin e zonave të ndarjes, lejimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve largimin e forcave të huaja, negocimin e marrëveshjes lokale për kontroll të armëve dhe bashkëpunimin me gjykatën ndërkombëtare të krimeve të luftës në rajon”². Pas vitit 1996 IFOR u zëvendësua me SFOR e cila u ngarkua me zbatimin e paqes brenda territorit të Bosnje e Hercegovinës. Për çdo përpjekje të vogël e të madhe për të funksionuar si një shtet sitë gjithë të tjerët duke ndihmuar në formimin e policisë apo të një ushtrie të përbashkët ka qenë “meritë e NATO-s e cila gjithmonë e ka stimuluar Bosnje dhe Hercegovinën duke ja dhënë mundësinë e partneritetit dhe zhvillimit të sajë në përgjithësi”(Mingst, 2010 f. 310).

Edhe pse pas shumë ndërhyrjesh që bënë për ta liruar Bosnje dhe Hercegovinën dhe partneritetit me organizatën ushtarake më të madhe botërore NATO, u lirua por gjithmonë mbeti peng e dëshirave të Republikës serbe të cilët haptazi janë kundër anëtarësimit të Bosnje dhe Hercegovinës në NATO.

2.4 Rasti i Malit të Zi

Mali i Zi është një vend që gjithmonë pati dëshirë që të anëtarësohej në një organizatë të tillë si NATO-ja. Pas shkëputjes dhe pas shpalljes së pavarësisë Mali i Zi në referendumin e 21 majit të vitit 2006 kishte zgjedhur të hyjë në NATO dhe në dhjetor të vitit 2008 aplikoi për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian. “Ajo vendosi objektivat dhe synimet e qarta për politikën e jashtme dhe zhvilloi strategji adekuat edhe punoi në atë sferë shumë që të jetë e aftë t'iu përshtatet legjislacionit Evropian, si dhe gjithmonë kontribuoi nën edukimin e personelit malazez për të kryer objektivat të cilat i kishin synuar”(Vukadanovic, 2017, *f. 191*).

Mali i Zi tani i kishte ndarë rrugët me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kishte filluar në ndërtimin e rrugës për në Unionin Evropian. Përpijekjet e Malit të Zi kishin filluar të merrnin jetë me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asocimi i cili kishte hapur shumë rrugë për të. “Në vitin 2009 për Malin e zi ishte miratuar Liberalizimi i regjimit të vizave me kontratën shengen, kurse statusin e kandidatit Mali i Zi e merr në vitin 2010 dhe me pas filloi negociatat për anëtarësimin e plotë në vitin 2012”(Vukadanovic, 2017, *f. 191*)

Mali i Zi ju afrua NATO-s, më së shumti për të pasur një lëvizje të lirë dhe të lehtë në Unionin Evropian, por në atë kohë Unioni Evropian kishte kriza të ndryshme si ato të sigurisë, energjisë, dhe bashkëpunimeve të ndryshme ku edhe rruga e Malit të zi drejt për në Unionin Evropian u ngadalësua. Malazezët u munduan të jenë të qëndrueshëm por ngadalësimi mungesa e transparencës në procesin negociues kanë dhënë rezultate në publik të lodhjes nga ana e malazezëve.

2.4.1 Mali i Zi dhe anëtarësimi në NATO

Pasiguria tashmë kishte filluar dhe vend mjaft të mirë kishte fituar në zemrat e malazezëve, pasiguria e pritjes bëri thirrje për anëtarësimin në NATO të cilat i kishin filluar reformat që do të zbatoheshin me ç'rast do të anëtarësoheshin, por kriza e rënduar ekonomike e sociale bëri që procesi prapë të ngadalësohej dhe të bëhej më pak e kapshme në shoqërinë malazeze.

Megjithatë, autoritetet zyrtare asnjëherë nuk hoqën dorë nga qëllimet e tyre të politikës së jashtme në anëtarësimin e tyre në NATO, dhe negociatat vazhduan pa u ndalur së insistuari për bashkëngjitjen e Malit të Zi në organizatën më të madhe për siguri në botë, të NATO-s. Në rrugën e Malit të Zi për në NATO, krahasuar me pjesën tjetër të Ballkanit perëndimor, duke përfshirë këtu të gjitha problemet që kanë hasur plus vendosjen e kriterëve shtesë specifike nga NATO-ja, ajo asnjëherë nuk u ndal së përmbushjes së kërkesave të njëpasnjëshme të cilat ju ishin vërsulur.

Dëshira ishte më e madhja se lodhja gjatë këtij rrugëtimi të mundimshëm, pavarësisht që ju refuzua disa herë kërkesa, rruga që kishin nisur kishte filluar të shkërtohej dhe të kishte më shumë shpresa për anëtarësimin e Malit të Zi në NATO, sepse asaj ju bë ftesa që ti bashkohej kësaj organizate që kah moti e kishte dëshiruar duke u anëtarësuar kështu në Aleancën Veriatlantike duke u bërë vendi i 29, “kjo bëri që ndikimi i Rusisë në Evropën juglindore të zvogëlohej dhe që hoqi qasjen “ujërvetë ngrohura” në Evropë që mund të bëheshin rrugë për sulme në Lindjen e Mesme”(Zeri i Amerikes, 2017).

2.5 Rasti i Maqedonisë

Si të gjitha vendet tjera të Ballkanit perëndimor edhe Maqedonia pati krizat e sajë dhe luftoi deri në frymën e fundit që t'i zgjidhte ato. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së Ohrit që pati e cila ndodhi që ti zgjidhte problemet dhe pabarazive etnike mes shqiptarëve të Maqedonisë dhe popullit maqedonas pasi e arritën zgjidhjen, e patjetërsueshme ishte dëshira e Maqedonisë që të merrte pjesë në NATO, duke u mbështetur kështu në iniciativën Amerikane apo në Kartën e Atlantikut.

Në vitin “2005 Maqedonisë iu dha statusi i kandidatit, por ende nuk ka arritur të mundësoj një kapitull negociues me Unionin Evropian”(Vukadanovic,2017 f. 193). Pas shpërbërjes së Jugosllavisë Maqedonia u mundua me çdo kusht që ta arrinte në rrugët Evropiane por ende nuk arriti t’i mbyllte me sukses ato rrugë që kishte punuar ti ndëronte ato më së miri. Maqedonia pati kriza politike e së fundmi pati më shumë sa që do duhej kjo krizë nuk është vetëm një përballje me strukturën qeverisëse, luftë kundër korrupsionit dhe dëshira për një jetë më të mirë por edhe një pjesë e një plani strategjik ndaj Maqedonisë që përfshin aktorë të mëdhenj strategjikë.

Një gjë tjetër tejet e rëndësishme për Maqedoninë ishte në vitin “2009 liberalizimi i regjimit të vizave për vendet Shengenit në bazë të marrëveshjes së Stabilizim asociimit por njëkohësisht që nuk ishin stimuj të mjaftueshëm për shoqërinë maqedonase që ti arrinte pikësyzimet e saj të cilat i kishte vendosur si objektiva për realizimin e politikave të tyre të cilat ende kanë probleme që në një të ardhme të afërme ndoshta do të zgjidhen”(Vukadanovic, 2017 f. 191).

2.6 Maqedonia dhe NATO-ja

Maqedonia kishte plotësuar kushtet që të ishte pjesë e organizatës më të madhe për siguri në botë dhe ishte gati që të bëhej pjesë e sajë, por vetoja greke bëri që ajo të mos ishte pjesë e sajë. Kjo për shkak të emrit sepse “pjesa veriore e Greqisë mban emrin Maqedonia. Kjo veto që u lëshua nga Grekët pati pasoja fatale afatgjata për pranimin e Maqedonisë në NATO dhe Unionin Evropian”(Klan Kosova, 2017). Pasi që u shpërbë Jugosllavia Maqedonia Sovrane nuk tregoi asnjëherë interesa territoriale ndaj Greqisë, por Greqia nuk reshti së dëshiruari kuadrin kulturor dhe historik dhe padyshim pandërprerë bënë presion që ta ndërronte emrin.

Pasi që Maqedonia kishte përafruar të gjitha gjërat që të anëtarësohej në NATO, qëndrimi i NATO-s ishte që të vazhdojnë të mbështesin qëllimin e Maqedonisë për anëtarësim, duke i mbështetur arritjet në sektorët mbrojtës dhe të sigurisë si dhe ti ndihmojë në zgjidhjen e

konflikteve mes sajë dhe Greqisë ku edhe u përfshi edhe Brukseli e cila doli të jetë e kotë dhe kundër produktive.

Në të dy vendet lulëzoi nacionalizmi, secila nga këto fituan pikë qoftë edhe negative nga ky konflikt, Greqia në njërën anë përfiton për qëllimet e brendshme politike, dhe në Maqedoni filloi një përçarje mes maqedonasve të cilët e kërkuan emrin e padiskutueshëm dhe shqiptarët të cilët gjithnjë e më shumë kërkojnë të sakrifikojnë emrin e vendit në rrugën e saj evropiane dhe euroatlantike, sepse ajo është konsideruar si çështje e parëndësishme.

2.7 Rasti i Serbisë

Serbia është në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor si shembulli më i mirë i Unionit Evropian dhe filtrimit nga dy palët për çështjen e integritit të këtyre vendeve në Unionin Evropian. Serbia ende ndjen efektet e luftës, pas rënies së ish-Jugosllavisë meqë nuk është pastruar nga këto ngjarje dhe në drejtim të integritit në NATO, nuk ka një konsensus përgjithësisht të pranuar nga të gjitha palët e partive politike në vend.

Specifike janë kriteret e vendosura nga NATO-ja, si një parakusht për anëtarësimin e të gjithave vendeve të prekura nga lufta pas rënies së Jugosllavisë. Ajo që më së shumti i pengoi Serbisë ka qenë shpallja e pavarësisë së Kosovës duke e acaruar tej mase. NATO, dhe Unioni Evropian, kontribuan dhe ende kontribuojnë në normalizimin e raporteve mes Prishtinës dhe Beogradit, kështu duke përdorur shpërblimin me dhurimin e lidhjeve institucionale me Unionin Evropian dhe NATO-n. Serbia me “29 prill të vitit 2008 ka marrë procesin e stabilizim asociativ duke revokuar regjimin e sajë të vizave për vendet e kontratës Shengen me 19 dhjetor 2009, ndërsa me 1 mars të vitit 2012 ka marrë statusin e vendit kandidat. Kurse negociatat me Unionin Evropian filluan me 21 janar të vitit 2014”(Vukadanovic, 2017 f. 195)

Serbia gjatë gjithë historisë së sajë për shkak të lidhjeve kulturore, fetare dhe ekonomike, madje edhe para se të bëhej futja e sanksioneve ka lidhjet më të mira politike të cilat janë ndër më të suksesshme të bashkëpunimit me federatën Ruse. Në përgjithësi ,vendet e Ballkanit Perëndimor për statusin e tyre institucional me NATO-n ende nuk e kanë fituar falë të

kaluarës së tyre dhe të tashmes që nuk kanë arritur ende një strategji për ta udhëhequr atë dhe duke poseduar paqëndrueshmëritë e mundshme ende institucionalizim është në pikëpyetje.

Kemi shumë shembuj të cilët janë integruar dhe kemi parë se integrimi në NATO nuk është pa dhimbje as i shpejtë, por në fund të fundit nëse ka një vullnet të përbashkët politik është gjithmonë i arritshëm. Sa i përket NATO-s, që është në Ballkanin perëndimor në fillim duhet të japë përparësi për stabilizimin e rajonit, vendosjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal e funksional. Por, për një kohë të gjatë e ka mbajtur këtë pozicion siç e ka edhe tani s'ka arritur ende normalizimin e marrëdhënieve në rajon NATO, duhet të këmbëngul për kushtëzim të fortë, pra plotësimin e kushteve dhe respekt për përafrimin e me standardet nevojshme të NATO-s. NATO-ja gjithnjë po hasë në vështirësi e sidomos gjithnjë e më ivështirë është përfaqësimi i modelit të dëshirueshëm të ndërtimit të shoqërive në Ballkanin perëndimor.

2.7.1 Rezultatet emisioneve të NATO-s në Ballkan

Pjesa e Ballkanit perëndimorë mund të themi që është një rajon me rëndësi strategjike për NATO-n. Është pikërisht NATO-ja, ajo organizatë që ka kontribuar me misionet të ndryshme në sigurimin dhe krijimin e paqes në Ballkanin Perëndimorë, e më së shumti në dy dekadat e fundit. Pikërisht ishte Ballkani Perëndimor që në vitet e 90-ta rilindi apo riktheu në jetë NATO-n me dy luftërat shkatërruese në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë, dhe i shtoi shkëlqimin dhe rëndësinë paqeruajtëse dhe paqendërtuese.

NATO-ja ka qenë shkaku i kryesor që të përfundojnë dy luftërat ndër etike në Ballkanin Perëndimor, gjë që e cila pati ndikim të madh në Evropë ngase ndihmoi që të largohet rreziku për ndonjë krizë nga shtetet fqinje. Këto vende dhe ky rajon gëzuan stabilitet dhe siguri pas intervenimeve të tyre. NATO-ja gjithmonë synoi të ruajë praninë e saj, fokusin në çështje të caktuara dhe angazhimin e palodhshëm në Ballkanin Perëndimor, për aq sa kohë ne t'i kërkojmë ndihmë dhe t'i mbështesim vlerat Euro-Atlantike. NATO-ja ka qenë ndër

iniciatorët kryesoretëngritjes së zërit për mbrojtjen e stabilitetit dhe paqes dhe poashtu për parandalimin e shumë krizave anë e mbanë botës. Kjo u bë falë ndihmesave në mënyra të ndryshme e të përshtatshme, në çfarë do kohe kur ju kërkuan asaj.

2.7.2 Kërkesat e NATO-s, ndaj Ballkanit perëndimor për anëtarësim

Në rastin e Ballkanit Perëndimorë hasen në gatishmërinë e forcave të NATO-s dhe aftësinë e pozicionimit të shpejtë në atë kohë. Njëra ndër mbështetësit me të madh ndaj vlerave demokratike është pikërisht kjo organizatë e cila marrëdhëniet e mira me fqinjët janë jetike për NATO-n. Nga Ballkani Perëndimor kërkuar medoemos angazhim të vërtetë përparim të vërtetë në reforma dhe që të pajtoheshin me ato vende që ende kishin konflikt në mes vete.

NATO-ja gjithmonë ishte përkrah asaj që vendet e Ballkanit Perëndimor të bashkëpunonin dhe të mbështeteshin në integrimin Euro Atlantik padyshim kjo vlen për ato vende që duan, dhe gjithnjë na ndihmuan pas luftës për një jetë sa më të mirë për qytetarët, pavarësisht asaj a duam apo jo t'ju bashkëngjitëm NATO-s. Në një far forme sa kishim dal nga një procesi tranzicioni ne edhe shumë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor ajo ndihmoi në fakt me ndërhyrje nga ana e jashtme e të brendshme.

“Duke përfshirë nëse kishte pirateri informatike propagandëapo nxitje të trazirave, të cilat ishin në kundërshtim me parimet dhe marrëdhëniet e mira ndërkombëtare”(Telegrafi, 2018). Për çdo vend të Ballkanit Perëndimor dera e NATO-s, ka qenë gjithmonë do të jetë e hapur për të gjitha demokracitë që janë në përputhje me vlerat e kësaj aleance të cilat do ti zbatonin me përpikëri dhe të tregojnë aftësi në përgjegjësitë dhe detyrimeve në një mënyrë. Ata zgjodhën një kauzë se përse do të shërbenin dhe ajo ishte shumë e thjeshtë, kontributi i tyre në sigurinë dhe stabilitetin e përbashkët. Që të jemi pjesë e një organizate të tillë nuk është aspak proces i lehtë dhe as i shpejtë. Madje kohëve të fundit nga vendet e Ballkanit Perëndimorë duke e përfshirë edhe vendin tonë kanë humbur durimin sepse duan të shohin rezultate të menjëhershme.

Arsyeja se pse procesi është i gjatëështë se së pari kërkon burime, kohë të mjaftueshme, vendosmëri, por kemi edhe nga ato vende që nuk duan të jenë pjesë të NATO-s, si

përshembull, Serbia, e cila respektohet të zgjedhë aleatët e sajë për çështjet e sigurisë. Pasi që të gjithë janë brenda organizatave të tilla, ato ballafaqohen me lloj lloj krizash duke i përfshirë kështu të gjitha vendet e poashtu edhe Ballkanin Perëndimor, përshembull ngritja e Rusisë në arenën ndërkombëtare është mjaftë delikate, trazirat e Lindjes së Mesme, ngjarjet e fundit të terrorizmit ngritja e emigracionit të cilët priremi për këtë fluks qëështë në ngritje çdo ditë e më shumë.

Për të dalë nga problemet që i prinin Ballkanit Perëndimor, NATO-ja ka qenë ajo që i propozoi projekte të njëpasnjëshme për një zgjidhje sa më tëmirë, por arritja e këtyre objektivave arrihet me bashkëpunim të ndërsjellë përmes projekteve të përbashkëta, por fatkeqësisht rindërtimi i zonave të shkatërruara nga lufta dhe pajtimi e demokratizimi i shoqërive të Ballkanit Perëndimor kanë ndodhur shumë ngadalë se ç'është planifikuar, dhe jo në mënyrë efikase. Jo pse nuk kanë kontribuar NATO-ja dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë, por nga mos marrja e përgjegjësi në mënyrë të duhur nga elitat që ishin dhe janë në krye të pushtetit.

Një gjë ishte e sigurt që kjo zonë delikate kishte nevojë për tu stabilizuar nga çështjet parimore që këto vende të sapo liruara dhe formuar rishtazi të fillojnë funksionin dhe të bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe të kuptojnë bindshëm kriteret që rrjedhin nga lufta si kthimin e personave të zhvendosur, refugjatet, pronën, bashkëjetesën dhe gjërat e tjera të ngjashme. “Që nga fillimi i viteve të90-ta e deri më sot, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një qëllim jetik të politikës së jashtme dhe disa nga ato janë Anëtarësimi në NATO, në Unionin Evropian”(Vukadinovic,2017 f. 187)

Shumë shpesh këto vende hasën më konsensusin politik dhe mbështetjen e fortë nga publiku, por ajo që nuk pati problem me asnjërën nga këto ka qenë Shqipëria e cila u integrua në NATO. Padyshim që jemi të vetëdijshëm se për integrimin e tillë nevojiten edhe mbështetës të fortë në fushën e arenës demokratike e politike, e njëra nga ta është edhe mbështetja ndaj Shqipërisë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët ishin aktorët kryesorë në komunitetin ndërkombëtar që në mënyrë diplomatike, por edhe prania specifike ushtarake në Shqipëri dhe

kriza shqiptare në pikat kufitare si me Greqinë, bëri që të integrohej për të parandaluar përshkallëzimin e krizës dhe konfliktit të armatosur.

Poashtu Shqipëria, që nga kriza në Ballkanin Perëndimor, është angazhuar në mënyrë të vendosur në rrugën e saj evropiane dhe euroatlantike. Ajo madje është anëtare ebesueshme dhe shumë aktive e NATO-s, por e metë e sajë ka qenë mos kryerja e reformave në shoqërinë e saj dhe nevojën për një shkallë më të lartë në integrimin evropian, sepse ka pasur dhe ende ka nivel të lartë të korrupsionit, mos funksionimi i shtetit të së drejtës dhe shkalla e lartë e aktiviteteve të ndryshme kriminale e cila ndikoi negativisht në institucionalizimin e marrëdhënieve e shteteve tjera e fqinje me Shqipërinë.

Për shumë vite NATO doli në mbrojtje të stabilitetit dhe paqes sepse ishte e zonja ti dilte krahë çështjeve kryesore që kishin të bëjnë me paqe apo luftë. Ajo gjithmonë ishte e besueshme dhe jo kërkuese e cila ishte gjithmonë në gjendjet gadishmërie dhe të jetë mbrojtëse kundër çdo kundërshtari apo kërcënimi që ju kanosej nga cilido vend ajo gjithnjë ishte ndër më të parat që u lajmëruan dhe morën në krahë armët për shpëtim e lirim, padyshim që bota për diçka të tillë pati nevojë që nga krijimi i saj, por me zhvillimin e qytet shteteve, popullsisë, territorit, krimet, punët ilegale, masakrat, luftërat e mëdha që kapluan mbarë tokën e banueshme, e patjetërsueshme ishte nevoja për një organizatë të tillë e cila u formua në atë kohë kur më së shumti u kërkua

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Që nga fillimi i luftërave që kanë prekur vendet e Ballkanit Perëndimorë studiuesit kanë dëshiruar që gjithmonë ta japin një përgjigje sa më të mirë për shkakun e fillimit të luftërave në këto vende dhe rezultatet që i pasuan ato ndër vite. Një copëz hapsire në hartë por mjaftë delicate për vendet tjera, jo aq e madhe sa kontinentet e tjera por me peshë mjaftë të rëndë, probleme ka pasur mjaftë shumë që kur diplomacia dhe politika vendosën që të frymonin, sepse vendet e ballkanit perëndimorë gjithmonë ka qenë mollë sherri se cili do ta pushtonte ose do ta merrte për gjithmonë.

Nga luftërat e shumta të njëpasnjëshme gjatë kësaj kohe që pasuan sa në një vend e sa në tjetrin edhe pse u liruan nga pushtuesit, pati problem të mëdha si në infrastruktur, politik, arsimim dhe në papunësi etj. Edhe pse janë bërë shumë studime mbi pasojat që trashëguan vendet e ballkanit perëndimorë pas luftës ballkanike, shumica prej tyre kanë ofruar mjaftë informacione lidhur me këtë çështje. Secili shtet i Ballkanit Perëndimorë është vrojtuar dhe analizuar, rreth veçorive të fillimi të luftërave dhe të mbarimit të tyre, dhe pasojat që prekën në favor të zhvillimit të vendit.

4 METODOLOGJIA

Për realizimin e kësaj teme janë përdorur disa qasje metodologjike të cilat shtjellohen si në vijim:

- Qasja teorike – janë analizuar librat dhe materialet teorike relevante dhe të fundit për të ndërtuar një kornizë teorike të qëndrueshme mbi të cilat u ndërtuar e gjithë tema. Përveç librave, janë përdorur edhe artikuj të ndryshëm nga revista relevante akademike. Kjo është bërë me qëllim që të jemi në trend me zhvillimet në këtë fushë duke i përdor materialet të përditësuar.
- Qasja historike- duke qenë se punimi përfshinë në vetëvete edhe aspektet historike është parë e nevojshme që të konsultohen shumë material nga historia dhe gjithashtu qasja narrative dhe evolutive një ndër stilet e shkrimit në këtë temë.
- Burimet sekondare- për realizimin e punimit u përdoren një sërë burimesh sekondare që më ndihmuan për analiza të ndryshme të realizuara nga institucionet e specializuara. Këto lloje të dhënash, e begatuan temën duke i shtuar edhe një komponentë mjaft të rëndësishme që lidhet me të dhënat statistikore.
- Burimet sekondare – për realizimin e punimit do të përdorën një sërë burimesh sekondare që do të merren nga analiza të ndryshme të realizuara nga institucione të specializuara. Këto lloj të dhënash, do e begatojnë temën duke i shtuar edhe një komponentë tejet të rëndësishëm që lidhet me të dhënat statistikore.

5 KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Nga të gjitha të dhënat dhe argumentet e paraqitura në këtëpunim diplome,mund të konstatohet se NATO është aktori dhe faktori më i rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor i cili është në gjendje të garantoj sigurinë dhe ruaj paqen në këtë botë të trazuar të zhvillimeve rapide globale ku shtetet janë në mënyrë permanente të sfiduar nga kërcënimet konvencionale dhe jo-konvencionale. Kjo organizatë, që njëkohësisht është edhe aktorë në marrëdhëniet ndërkombëtare, ishte ajo që u mundua të rikthente paqen dhe stabilitetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor pas mosmarrëveshjeve dhe luftërave që ndodhen në këtë zonë gjatë viteve të 90-ta. Nga ky studim i detajuar u deduktua se ajo që e karakterizoi Ballkanin Perëndimor ka qenë mos menaxhimi i shpejtë dhe me diplomaci pas atyre gjërave që kaluan, por normalisht duhet cekur se pati edhe prej atyre që e rimorën vetën brenda një kohe shumë të shkurtër.

Emigrimi nga ana tjetër ka qenë dhe është ende tema aktuale apo problem i thellë që po i varfëron vendet e Ballkanit Perëndimor. Nga pas lufta pati shumë kriza politike të cilat ndikuan dukshëm në zhvillimet e kapitalit njerëzor. Ikja e individëve të arsimuar dhe tëpërgatiturnëspecializime dhenë lëmi tëndryshme ndikoi dukshëm në procesin e tranzicionit. Rrjedhimisht, në këto vende të Ballkanit Perëndimorë ka pasur tranzicion dhe kriza politike, emigrimi, korrupsioni ndikuan shumëqë të mos kishte zhvillimin e mirë të saj.

I tillë është bilanci i rëndë me të cilën mbyllet lufta e Ballkanit Perëndimorë e tillë është trashëgimia e tmerrshme me të cilën u shoqërua rikthimi i paqes me ndihmën e NATO-s, sepse stabiliteti dhe paqja kudo në botë ku kërcënohej NATO-ja ishte ajo për kontributin e rikthimit të saj me të gjitha format që posedonte.

Roli dhe rëndësia e NATO-s është i pazëvendësueshëm në garantimin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Shqipëria, tashmë pjesë e NATO-s që nga viti 2009, është partner jetik dhe strategjik i saj në këtë pjesë të globit. Përkushtimin dhe gatishmërinë e saj ajo e tregoj jo vetëm me anëtarësim, po në marrjen pjesë– nëkuadër të kushteve dhe të mundësive të saj – në disa misione të NATO-s nëpër botë. Kosova ende trajtohet nga NATO si çështje e jo si aktorë sepse nuk është njohur nga të gjitha shtetet anëtare të saj, mirëpo NATO që nga 1999

ka prezencën e saj aty nëpërmjet misionit të KFOR-it. Në anën tjetër, vullneti politik dhe disponimi popullor i Kosovës është i qartë – integrimi drejtë strukturave veriatlantike. Mali i Zi është anëtarë më i ri i NATO-s nga rajoni. Anëtarësimi i këtij shteti e rrit sigurinë në këtë region duke shërbyer edhe si aktorë strategjik për të mbajtur Rusinë jashtë mundësisë për qasje në Detin Adriatik. Maqedonia ishte e gatshme që së bashku me Shqipërinë të anëtarësohej në NATO më 2009, po për shkak të kontestit me emrin që ka me Greqinë një gjë e tillë nuk ndodhi. Pritet që ky problem të zgjidhet së shpejti dhe atëherë edhe Maqedonia e ka rrugën e hapur drejtë këtij integrimi. Bosnja ka një prani të NATO-s në territorin e saj dhe në të njëjtën kohë ka orientim euroatlantik. I vetmi shtet që duket që nuk ka disponim integruar në këtë organizatë është Serbia e cila edhe ishte bombarduar nga NATO më 1999. Ky shtet luan me 2 karat: është në bashkëpunim të ngushtë edhe me aleatin e saj strategjik, Rusinë, por edhe me Bashkimin Evropian. Megjithatë, konsiderohet se në një të ardhme jo të largët edhe Serbia nuk do të ketë alternativë integruese përveç perëndimit dhe vlerave që ai përfaqëson.

7 REFERENCAT

- Avdiu, P. (2017, 01). Retrieved 04 07, 2018, from [http://www.qkss.org/repository/docs/NATO_ALB_\(5\)_831824.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/NATO_ALB_(5)_831824.pdf)
- Reka B. et.al. “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, Kapitulli III, Subjektet e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. (Shkup, 2016).
- Armstrong, D. L. L. (n.d.). *Organizatat Nderkombetare ne Politiken Boterore*. Albanian Institute for International Studies (AIIS. 2009
- Emini, A. (2014). *Aspekti Historik i Mevtesise se Kosoves*. Retrieved 06 04, 2017, from Moodle.
- Ideja Evropiane nga Karli i Madh deri te Unioni Evropian*. Instituti për studime Politike dhe Ndërkombëtare. Shkup. 2017
- Klan Kosova*. (n.d.). Retrieved 10 02, 2017, from Gruevski: Maqedonia nuk hyri në BE dhe NATO faji i Greqisë: <http://klankosova.tv/gruevski-maqedonia-nuk-hyri-ne-be-dhe-nato-faji-i-greqise/>
- Kumanova, E. (n.d.). Retrieved 06 26, 2017, from <http://edmondkumnova.weebly.com/2/post/2009/10/konflikti-n-bosnje-hercegovin-dhe-marrveshja-e-dayton-it.html>
- Mingst. K.A. Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Albanian Institute for International Studies (AIIS). Tiranë. 2010.
- NATO, Historia e aleances se veriatlantikut*. (n.d.). Retrieved 05 17, 2017, from http://www.ikub.al/SHKOLLA_CATEGORY/1310020107/Article-NATO-historia-e-Aleances-te-Atlantikut-te-Veriut-.aspx
- Plator, A. (n.d.). *Shqyrtimi i Pergjigjes së NATO-S*. Retrieved from [http://www.qkss.org/repository/docs/NATO_ALB_\(5\)_831824.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/NATO_ALB_(5)_831824.pdf)
- Radonoviç, R. (n.d.). *Ideja Evropiane nga Karli i madh*.

Telegrafi . (n.d.). Retrieved 11 05, 2017, from Gjenerali i NATO-s, për rreziqet në Ballkanin Perëndimor: Sulmi ndaj një aleati do të përballohet nga tërë Aleanca: <https://telegrafi.com/gjenerali-nato-s-per-rreziqet-ne-ballkanin-perendimor-sulmi-ndaj-nje-aleati-te-perballohet-nga-tere-aleanca/>

Zeri i Amerikes. (2017). Retrieved 09 30, 2017, from Mali i Zi zyrtarisht anëtar i NATOS: <https://www.zeriamerikes.com/a/3887231.html>